



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:245260
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05476490

C.nr.2324/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – **Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit E.M. me numër personal, me vendbanim në fshatin komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. B.J. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" SH.A, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 4,600.00 €, në seancën e mbajtur të shqyrtimit gjyqësor, me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET** së është tërhequr padia me numër C.nr.2324/21, e paditësit E.M. nga fshati Korishë, komuna e Prizrenit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" SH.A, me seli në Prishtinë, në çështjen juridike me objekt të kontestit kompensim i dëmit.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi E.M. nga fshati komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" SH.A, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 4,600.00 €.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.03.2024, nuk ka prezantuar paditësi, dhe e paditura edhe pse gjykata ka pasur prova se të nijetit janë ftuar në mënyrë të rregullt.

I autorizuari i paditësit me parashtresën e datë 20.03.2024, e dorëzuar përmes postës - emailit elektronikë pranë kësaj gjykate, e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese me të paditurën kanë pajtim jashtë gjyqësore, dhe se e TËRHEQ PADINË.

Andaj nga të lartcekura, Gjykata në kuptim të nenit 261 par.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ka marrë aktvendim si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2021:245260
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05476490

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 par.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:245260, 20.03.2024

G j y q t a r i,

Baki Shigjeqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenin 261 par.4 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa.